

08-116/3
14.04.23
-3-



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice-Departamenti për
Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.05/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P. nr. 128/2020, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, pala ankuese, seanca është mbajtur në praninë e palës ankuese dhe përmbaruesit privat, me datë 13.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Organi përmbarues - Përmbaruesi Privat, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore, është përgjegjës për shkelje disiplinore, tejkalim i autorizimit të besuar me ligj, ashtu që të njëjtit i shqiptohet masa disiplinore, gjobë në të holla, në shumën prej 1,300.00 euro (njëmijë e treqind), të cilën detyrohet të paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Kosovës, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m

Pala ankuese me datë 27.01.2023, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat, pranë të cilës ka mbetur edhe në seancën dëgjimore. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat me ndërmarrjen e veprimeve përmbarimore lidhur me lëndën përmbarimore P. nr.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor mori parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht faktin peshën e dëmit të shkaktuar ndaj palës ankuese, e cila ka do të ndikonte në lartësinë e masës së shqiptuar. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar me gjobë në të holla bazuar në nenin 368 paragrafi 1 nën paragrafi 3 i LPP-së, i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat e rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve e përmbarimore, të përmbaruesi privat si dhe tek përmbaruesit tjerë privat që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka, në thelb, është edhe qëllimi i masës. Ndërsa detyrimin se ku duhet të bëhet pagesa e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi, u bazua në nenin 368 paragrafi 3 të LPP-së, në të cilën përcaktohet se gjobat në të holla paguhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 05/2023 datë 13.04.2023

Kryesuese e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.